



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 75.
Prishtinë, më 19.07.2013 në ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Jasmina Živković, Glauk Konjufca, Petar Miletic, Vesna Mikic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësues nga IND- ja Xhemajl Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, ECMI Lura Pollozhani dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, praktikantja Fjolla Gashi, nga UNDP-ja.

Mbledhjen e kryesoi: **Elmi Recica** zëvendëskryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës,**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amandamentet e Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administrat Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapsinor me amandamente të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor.**

Kryesuesi - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës

Kryesuesi – paraqet për shqyrtim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në fjalinë e tij tha se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka ligjetimuar ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Tani është në procedurë Projektligji për rishikimin e Buxhetit dhe pasi gjendemi në fund të muajit korrik duhet të ketë aryeshmërinë e rishikimit të buxhetit për gjashtë mujorin e dytë të po këtij viti. Si komision jemi të thirrur që të bëhet rishikimi i buxhetit nga aspekti i respektimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Mufera Sinik – tha se nuk ka vërejtje në amandamentimin e projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa ngriti çështjen se në vitin 2013 për komunitetin turk, është miratuar buxheti me vlerë prej 150.000 euro. Ajo ceku se Ministria e financave për ndërtimin e shtëpisë së kulturës në Mitrovicë, ka aprovuar buxhetin me vlerë prej 87.000 euro, kurse deri më tani janë alokuar mjetet prej 32.000 euro.

Sa i përket Rishikimit të buxhetit për komunitetin turk janë ndarë 20.000 euro. Mirëpo është e padrejtë nga se shuma prej 32.000 dhe 20.000 euro, arrijnë vlerën në 52.000 euro. Andaj komuniteti jonë nuk kërkon më tepër se sa vlera prej 87.000 euro, të cilën ministria e ka aprovuar qysh në fillim.

Ajo konstatoi, nëse për këtë projekt nuk ndahen edhe 30.000 euro, komuniteti jonë do të votojë kundër miratimit të rishqyrtimit të buxhetit për vitin 2013.

Kryesuesi – Komisioni funksional për buxhet dhe financa ka pasur shumë konsideratë për kërkesat e të gjitha komuniteteve dhe organizatave tjera buxhetore ku ka pas në konsideratë që një pjesë e projekteve të mos anulohen. Mirëpo në bazë të implikimeve buxhetore që kanë rrjedh nga marrëveshja për normalizimin e raporteve në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ka ndikuar që një pjesë e tyre të zvogëlohen.

Jelena Bontic – kur bëhet fjalë për rishikim të buxhetit, duhet të jemi tolerant pasi gjithmonë ka vend për realizimin e projekteve të ndryshme për komunitete. Gjithashtu ceku se përfaqësimi i komunitetit të SLS, është i kënaqur me ndarjen e mjeteve buxhetore.

Albert Kinolli – tha se ka dhënë kontribut në të gjitha proceset për atë kohë sa është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ne si deputet dhe si pjesë e koalicionit qeverisës kemi kërkuar buxhet në vlerë prej 1.5 miliard euro. Prej vitit 2011 deri më 2013, qeveria nuk ka pasur gatishmëri që të sigurojë 153.000 euro për komunitetin rom. Nuk e ka të qartë pse për tri vitet e fundit për një komunitet të caktuar janë alokuar mija euro, ndërsa për komunitetin tonë nuk ka mundësi të ndahet shuma e premtuar.

Kryesuesi – me theks të veçantë tha se me këtë rishikim të buxhetit nuk do të cenohen dhe shkelen të drejtat e komuniteteve. Njëherit i ftoi anëtarët e komisionit që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me pesë vota 'për' dy 'kundër' dhe një 'abstenim' nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administrat Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- III. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapsinor me amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor;**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-174 për Planifikim Hapsinor me amandamente të Komisionit FunkSIONAL dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk kishte vërejte, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- V. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-174 për Planifikim Hapsinor dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- VI. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zevendeskryetari i parë i Komisionit

Elmi Recica